



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE DHE NDRIÇIMIT PUBLIK

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Datë 27/07/2020

Nga: Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndrëçimit Publik.

Drejtuar: Shoqërisë “**KUJTIMI 06**” shpk me NUIS K61911016R me adresë: Rruga Tiranë - Kamëz, Bulevardi Blu, 150 M, pranë Kryqëzimit për Zallherr, Kamëz, Tiranë.

Procedura e prokurimit: Kërkesë për Propozim.

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-58837-05-22-2020.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Blerje bateri, goma, vaj etj” afati: 30 (tridhjetë) ditë nga nënshkrimi i kontratës.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Publikime të mëparshme (*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 32, Date 01.06.2020.

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara si më poshtë:

1. Operatori ekonomik “**EXIMOIL**” sha me NUIS K91715006E, me ofertë ekonomike **5.507.800** (pesë milion e pesëqind e shtatë mijë e tetëqind) lekë pa tvsh.
2. Bashkimi i Operatorëve ekonomik “**GAJD Company**” shpk me NUIS K79631501Q dhe “**SI & CO COMPANY**” shpk me NUIS L21420002F, me ofertë ekonomike **5.494.600** (pesë milion e katërqind e nëntëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind) lekë pa tvsh.
3. Operatori ekonomik “**KLOSI-R COMPANY**” shpk me NUIS L72120030I, me ofertë ekonomike **5.200.000** (pesë milion e dyqind mijë) lekë pa tvsh.
4. Operatori ekonomik “**KUJTIMI 06**” shpk me NUIS K61911016R, me ofertë ekonomike **5.485.300** (pesë milion e katërqind e tetëdhjetë e pesë mijë e treqind) lekë pa tvsh.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. “**EXIMOIL**” sha me NUIS K91715006E

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

- Nuk përmbush pikën 2.3.7 të kapacitetit teknik ku parashikohet se “*Operatori ekonomik duhet të dorëzojë mostrat e mallrave të mëposhtëm, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndrëçimit Publik, në datën dhe orën e hapjes së*

ofertave. Mosparaqitja e tyre përbën kusht për s'kualifikim".

- Gomë 440/28R 28 1 copë
- Bateri 12 V 165 Ah 1 copë
- Vaj motorri 15W-40 1 copë

Nga verifikimi i mostrave të paraqitura pranë Autoriteti Kontraktor rezulton se operatori ekonomik "EXIMOIL" sh.a ka paraqitur bateri, e cila nuk është në përputhje me specifikimet teknike të parashikuara në shtojcën 9 dhe me fuqinë e kërkuar sipas pikes 2.3.7 të kapacitetit teknik. Bateria e paraqitur nga operatori ekonomik "EXIMOIL" sh.a është 12 V 180 Ah dhe jo 12V 165 Ah sipas kërkesës. Gjithashtu ajo është jo hermetike, pa sy magjik, dhe pa xhel në kundërshtim me specifikimet teknike e kërkuara ku parashikohet se bateritë duhet të jenë hermetike, me sy magjik dhe me xhel.

2. "GAJD Company" shpk me NUIS K79631501Q dhe "SI & CO COMPANY" shpk me NUIS L21420002F

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

- Nuk përmbush pikën 2.3.7 të kapacitetit teknik ku parashikohet se "*Operatori ekonomik duhet të dorëzojë mostrat e mallrave të mëposhtëm, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, në datën dhe orën e hapjes së ofertave. Mosparaqitja e tyre përbën kusht për s'kualifikim.*
- Gomë 440/28R 28 1 copë
 - Bateri 12 V 165 Ah 1 copë
 - Vaj motorri 15W-40 1 copë

Nga verifikimi i mostrave të paraqitura pranë Autoriteti Kontraktor rezulton se BOE "Gajd Company" sh.p.k dhe "Si & Co Company" sh.p.k kanë paraqitur bateri, e cila nuk është në përputhje me specifikimet teknike të parashikuara në shtojcën 9. Bateria e paraqitur nga BOE "Gajd Company" sh.p.k dhe "Si & Co Company" sh.p.k nuk është hermetike në kundërshtim me specifikimet teknike të kërkuara, ku parashikohet se bateritë duhet të jenë hermetike, me sy magjik dhe me xhel.

3. "KLOSI-R COMPANY" shpk me NUIS L72120030I.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

- Nuk përmbush pikën 2.3.7 të kapacitetit teknik ku parashikohet se "*Operatori ekonomik duhet të dorëzojë mostrat e mallrave të mëposhtëm, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, në datën dhe orën e hapjes së ofertave. Mosparaqitja e tyre përbën kusht për s'kualifikim.*
- Gomë 440/28R 28 1 copë
 - Bateri 12 V 165 Ah 1 copë
 - Vaj motorri 15W-40 1 copë

Nga verifikimi i mostrave të paraqitura pranë Autoriteti Kontraktor rezulton se operatori ekonomik "Klosi-R Company" sh.p.k ka paraqitur bateri, e cila nuk është në përputhje me specifikimet teknike të parashikuara në shtojcën 9 dhe me fuqinë e kërkuar sipas pikes 2.3.7 të kapacitetit teknik.

Bateria e paraqitur nga operatori ekonomik "Klosi-R Company" shpk është **12V170 Ah** dhe jo 12V 165 Ah sipas kërkesës. Gjithashtu ajo është jo hermetike, pa sy magjik dhe pa xhel në kundërshtim me specifikimet teknike e kërkuara ku parashikohet se bateritë duhet

të jenë hermetike, me sy magjik dhe me xhel.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik Operatori ekonomik **“KUJTIMI 06” shpk** me NUIS K61911016R, me adresë Rruga Tiranë - Kamëz, Bulevardi Blu, 150 M, pranë Kryqëzimit për Zallherr, Kamëz, Tiranë, dhe me ofertë ekonomike **5.485.300** (pesë milion e katërqind e tetëdhjetë e pesë mijë e treqind) lekë pa tvsh, **është identifikuar si ofertë e suksesshme.**

Rrjedhimisht, jeni të lutur të paraqisni pranë **Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik**, Rruga 5 Maji, sigurimin e kontratës siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve që nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i klasifikimit është bërë në datë 03.07.2020.

Ankesa: Ka më datë: 01.06.2020.

Ka marrë përgjigje më datë: 02.06.2020.

Ankesa: Ka më datë: 08.07.2020.

Ka marrë përgjigje më datë: 14.07.2020.